

Migrare

CONVEGNO
NAZIONALE



COMPLESSO
MONUMENTALE
DELLO STERI

20-22 | 5 | 2019

PIAZZA MARINA 61
PALERMO

Thirrje Europës së dijes



www.unipa.it



Ministero
dei beni e delle
attività culturali
e del turismo



REGIONE SICILIANA
Assessorato dei Beni culturali
e dell'Identità siciliana
Dipartimento dei Beni culturali
e dell'Identità siciliana



fondazione
ignazio buttitta



INIZIATIVA INSERITA NEL PROGRAMMA



PROMOSSO
DA



Thirrje Europës së dijes

Ne gratë dhe burrat që punojmë, studiojmë dhe zhvillojmë kërkime në Universitetin e Palermos u drejtohem grave, burrave dhe të rinjve të tjerë të universiteteve europiane për t'u kërkuar atyre të krijojmë së bashku një hapësirë të madhe reflektimi dhe veprimi që të vërë në qendër të vëmendjes temat e të drejtave dhe të barazisë së njerëzve, sidomos të migrantëve, dhe që të trajtojë edhe të drejtat e brezave të ardhshëm.

Besojmë se është e rëndësishme që kjo thirrje të niset nga Universiteti ynë, sepse Sicilia ka qenë dhe është teatër qoftë i emigrimit, qoftë i imigrimit. Jemi të vetëdijshëm për dhunimin e rëndë të dinjitetit njerëzor të mijëra grave dhe burrave, të rinjve dhe fëmijëve migrantë që janë përpjekur më kot të zbarkojnë në portet tona, si edhe të atyre që ia kanë dalë të zbarkojnë. Njohim edhe arsyet pse shumë të rinj të tjerë nga Jugu i Italisë dhe nga Europa mërgojnë gjetkë, në kërkim të një jete të ndryshme nga ajo që u ofron vendi tyre. Pra jemi plotësisht të ndërgjegjshëm se në vendet përreth Mesdheut po projektohet e ardhmja, jo vetëm e Europës.

Besojmë se roli i Universitetit është që të ndihmojë në ndërtimin e një njohjeje të qëndrueshme, larg sloganeve dhe thjeshtëzimeve, të bazuar në të dhëna të sigurta e në procese arsyetimi të përshtatshme. Kjo njohje kritike, e karakterizuar nga kërkimi racional dhe nga refuzimi i gjuhës së urrejtjes dhe frikës, është i vetmi mjet i besueshëm për të siguruar zgjedhje të drejta në lëmin e politikave migratore, zgjedhje që të garantojnë të drejtat e paprekshme të njerëzve dhe të favorizojnë mikpritjen e të huajve dhe të të ndryshmëve, duke krijuar njëherazi kushtet për një afirmim më të mirë të të rinjve në Jugun e Europës dhe gjetkë. Prandaj mendojmë se është detyra jonë të promovojmë dhe të mbështetim qarkullimin sa më të gjerë dhe ballafaqimin e studentëve, të kërkuesve shkencorë dhe të ideve në sistemet arsimore dhe universitare të gjithë botës.

Ka ardhur koha të ndërmarrim një reflektim dhe një veprim të përbashkët rreth pikave të mëposhtme:

1. Akti i të mërguarit duhet kuptuar si pjesë përbërëse e sfidave globale të sotme: ndryshimet klimatike, pakësimi i burimeve parësore të parinovueshme (toka dhe uji) dhe mungesa e burimeve ushqimore të qëndrueshme, sundimi i kapitalizmit financiar mbi ekonominë reale, afirmimi i autoritarizmave që përbëjnë rrezik të madh për demokracinë dhe liritë njerëzore. Njohja e së drejtës së mërgimit brenda një kuadri në zgjerim e sipër si zhvillim i të drejtave globale mund të përbëjë një ndihmesë të madhe për promovimin e demokracisë dhe të lirisë qoftë për brezat e sotëm, qoftë për ata të ardhshëm.
2. Politikat migratore italiane dhe europiane duhet të mbrojnë njeriun si bartës të drejtash themelore të njohura nga komuniteti ndërkombëtar, duke filluar me të drejtën për shëndetin në kuptimin më të gjerë të fjalës. Shtrohet nevoja e garantimit të të drejtave njerëzore për subjektet e dobëta, të sanksionuara në kushtetutë, por në të vërtetë të shkelura shpesh. Ato të drejta mbrohen edhe nga Karta Universale e të Drejtave të Njeriut (që tashmë ka mbushur 70 vjet dhe që në nenin 14 i njej çdo individ të drejtën njerëzore "të kërkojë dhe të marrë strehim nga persekutimet"), nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European, nga Kushtetuta italiane dhe nga kushtetutat e të gjitha shteteve demokratike. Politika të tjera, që mohojnë lirinë e lëvizjes në botë të qenieve njerëzore, përbëjnë një kthim prapa për qytetërimin e të gjitha shteteve që i zbatojnë ato.

3. Jeta njerëzore është në rrezik dhe dinjiteti cenohet sa herë që një qenie njerëzore vihet në kushte vështirësie ekstreme, sikurse po ndodh jo vetëm në Mesdhe (apo në shkretëtirën e Saharës), por edhe në të gjitha vendet e kalimit ku njerëzit u nënshtrohen burgimit, torturave dhe dhunës seksuale. Indiferenca ndaj asaj çka po ndodh dhe shpërfillja ndaj jetës njerëzore cenojnë themelet e qytetërimit tonë, që është ngjizur edhe përmes refuzimit të përvojave tragjike të së shkuarës. Qëndrime këto tejte të rënda, sepse racizmi shpesh nuk është shkak, por pasoja e shtypjes dhe dhunimit të të drejtave të subjekteve më të dobëta.
4. Edukimi dhe formimi janë mjetet kryesore me të cilat mund të ndërtohet respekti dhe vlerësimi ndaj dallimeve, si dhe lufta ndaj pabarazisë ekonomike dhe sociale. Është e rëndësishme që ky parim të zbatohet qoftë në praktikën arsimore të të rinjve europianë për t'i ndërgjegjësuar ata mbi kompleksitetin e shoqërive të sotme, qoftë ndaj qytetarëve të rinj dhe ndaj migrantëve, nga më të vegjlit deri te të rriturit, pasi kushdo që mërgon ka të drejtë të mësojë kulturën dhe gjuhën e folur e të shkruar të vendit ku vendoset, si kusht themelor për një përfshirje të vërtetë. Krijimi i projekteve edukative të hapura ndaj pikëpamjeve të ndryshme është hapi i parë për të çrrënjësuar paragjykimet dhe për të ndërtuar mënyra të reja bashkëjetese në botë.

Traduzione di **Gezim Gurga** (UniPa)

